

Si duhet ta ndiqni problemin në vazhdim?

- Bëni një plan. Shkruani gjërat që ju dhe mësuesi do të bëni në mbështetje të fëmijës. Ju mund ta bëni këtë gjatë ose mbas takimit. Shkruani se çfarë duhet të bëni ju, mësuesi dhe fëmija juaj, kur dhe sa shpesh ka nevojë t'i bëjë. Bëni një plan për t'u takuar me mësuesin në muajt e ardhshëm.
- Planifikoni një takim tjetër për të biseduar. Komunikimi duhet të jetë i dyanshëm. Pyesni se si mund ta kontaktoni mësuesin. Dhe mos harroni të pyesni se si mund t'ju kontaktojë juve mësuesi. Ka shumë ura komunikimi—personalisht, me telefon, njoftime me shkrim, e-mail. Bëni një plan që funksionon për të dy palët. Sigurohuni që shkolla ka informacionin aktual të kontaktimit tuaj dhe planifikoni të paktën një takim për të biseduar me mësuesin në muajt e ardhshëm.
- Flisni me fëmijën tuaj. Takimi prind-mësues ka në plan të parë fëmijën tuaj, kështu që mos harroni t'i përfshini ata. U tregoni fëmijës suaj se çfarë mësuar dhe ndani me të planin e veprimt që përpunuat me mësuesin. Shpjegoni se si do ta ndihmoni ju me mësimet në shtëpi dhe diskutoni me të, se çfarë i duhet atij të bëjë. Kërkoni nga fëmija juaj t'ju jap sugjerimet e tij/saj.

Mbani në vëmendje, se secili fëmijë është i ndryshëm dhe i veçantë. Secili ka personalitet të veçantë dhe interesa të ndryshme; secili reagon ndryshe ndaj stimujve të ndryshëm dhe mëson në mënyra të ndryshme. Fëmijët e hedhin hapin e tyre të parë drejt zbulimit të botës dhe jo gjithmonë bëjnë zgjedhjet e duhura. Secili fëmijë apo adoleshentë ka në vetvete potencial për të ndryshuar botën duke bërë zgjedhjet e duhura dhe ndjekur endërrat e tyre. Duke i mbështetur, udhëhequr dhe inkurajuar ata drejt së ardhmes së tyre, ne, gjithashtu, kemi aftësitë për të bërë një botë më të mirë. Le ta bëjmë atë sëbashku!

Përshtatur nga "Këshilla për Drejtorë, Mësues, dhe Prindër mbi takimet Prind-Mësues", të Projektit Kërkimor mbi Familjen të Harvardit (<http://www.hfrp.org/family-involvement/publications-resources/parent-teacher-conference-tip-sheets-for-principals-teachers-andparents>) dhe "Përgatija për një takim të suksesshëm Prind-Mësues" nga Diane Milne (<http://www.education.com/magazine/article/tips-successful-parent-teacher-conference>).

Zyra e Angazhimit të Prindit, Familjes, Komunitetit & Partneriteteve të Besimit

440 N. Broad Street, Room 114, Philadelphia, PA 19130

DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS

Zyra e Angazhimit të Prindit, Familjes, Komunitetit dhe

Partneriteteve të Besimit

Si t'i bëjmë takimet Mësues-Prindër

frutshme për fëmijën tuaj

(Albanian)



Parents Are Our Partners



Nxënësit kalojnë vetëm një të katërtën e jetës së tyre aktive në shkollë. Gjatë kësaj kohe ata kanë nevojë të punojnë shumë për marrjen e dijeve dhe aftësive që do të formojnë bazën e suksesit të ardhshëm në jetë.

Njerëzit me baza arsimore të shëndosha në lexim, matematikë, studime sociale dhe shkencë do të kenë mundësi punësimi më të mirë në të ardhmen, fitojnë pagë më të mirë, japin kontribut më të madh në shoqëri, dhe bëjnë një jetë më të frutshme. Por ka dhe faktorë të tjerë që kontribuojnë drejt suksesit, përfshirë cilësitë e kreativitetit, kurioziteti intelektual, motivimi, pavarësia dhe aftësia ripërtëritëse; po ashtu edhe aftësia e mendimit analitik dhe kritik, mënyra e zgjidhjes së problemeve, komunikimi, organizimi, menaxhimi i kohës dhe zhvillimi i marrëdhënieve ndërpersonale.

Puna e përbashkët me mësuesin e fëmijës suaj do të ndihmojë në suksesin e fëmijës jo vetëm të atij mësimit, por edhe social dhe emocional. Kur prindërit dhe mësuesit punojnë sëbashku çdo ditë për të mbështetur dhe plotësuar përpjekjet e njeri tjetrit, ata mund të ndërtojnë një bazë të fortë për suksesin e fëmijës.

Kjo letër këshilluese do t'ju ndihmojë në fillimin e bashkëbisedimit me mësuesin rreth edukimit të fëmijës suaj, një bashkëbisedim që do të rrit partneritetin, mesazhin dhe mësuesit në punën e përbashkët për të mbështetur fëmijën.

Çfarë duhet të prisni?

Projekti Kërkimor mbi Familjen i shkollës së Harvardit sugjeron se një takim i frutshëm prind-mësues do të përfshijë karakteristikat e mëposhtme:

▶ **Bashkëbisedim i dyanshëm.**

Si të gjitha bisedat e frutshme, takimet prind-mësues janë të mira kur të dy pjesëmarrësit flasin dhe dëgjojnë njëri tjetrin. Takimi është rasti që ju mund të mësoni mbi përparimin e fëmijës tuaj në



shkollë: të kërkonit që të shikoni të dhënat mbi frekuentimin e fëmijës tuaj, notat dhe rezultatet në teste. Kërkonit të dini nëse fëmija juaj arrin standardet akademike shkollore.

Kjo është gjithashtu koha për mësuesin që të mësojë se si fëmija juaj sillet në shtëpi. Kur ju u flisni mësuesit mbi aftësitë, interesat dhe ëndërrat e fëmijës tuaj, ai mund t'ju ndihmojë më shumë.

► *Vëmendja t'i kushtohet mësimit.*

Takimet e efektshme prind-mësues fokusohen në planin se, sa mirë ecën fëmija në shkollë. Ata gjithashtu duhet të flasin se si të ndihmojnë në përmirësimin e tij/saj. Për t'u bërë gati për këtë bashkëbisedim, shikoni detyrat e shtëpisë së fëmijës, testet dhe njoftimet e shkollës përpara takimit. Sigurohuni të sillni një list me pyetje që do të dëshironi t'ia bëni mësuesit.

► *Oportunitetet dhe sfidat.*

Ashtu si dhe ju, mësuesit duan suksesin e fëmijës tuaj. Ju ndoshta do të dëgjoni fjalë të mira nga mësuesi për përparimin e fëmijës tuaj dhe fushat e përmirësimit. Duhet të përgatiteni më përpara për të folur mbi sfidat dhe pikat e forta të fëmijës. Duhet të përgatiteni për të bërë pyetje për mënyrat se si ju dhe mësuesi mund të ndihmojnë fëmijën tuaj në sfidat e tyre.

Para takimit:

- Rishikoni orarin e takimit. Nëse ju nuk mund të shkoni në takim në orarin e caktuar, kërkonit nga mësuesi për një orar tjetër. Nëse nuk mund të jeni prezent, kërkonit takim me telefon.
- Flisni me fëmijën tuaj rreth mësimeve. Çfarë po shkon mirë? Çfarë lëndësh dhe detyrash pëlqen dhe bën më mirë fëmija, dhe cilat detyra janë më të vështira? A ka ndonjë gjë që fëmija nuk e kupton apo ka vështirësi?
- Rishikoni punën, notat dhe raportin mbi progresin e fëmijës.
- Flisni me të tjerët—pjestarë të familjes, personelin e programit mbas mësimit, mentorë, etj.—mbi pikat e forta dhe nevojat e fëmijës.
- Mendoni mbi mënyrat që do të dëshironit për t'u angazhuar në mësimin e fëmijës në mënyrë që të diskutoni ato me mësuesin.
- Bëni një listë me pyetje që do t'ju duhen gjatë takimit.

Këtu keni disa nga pyetjet që mund të përfshini në këtë listë:

1. Standardet dhe Përmbajtja Akademike:

- Çfarë do të mësojë nxënësi këtë vit shkollor në lëndët bazë si Matematika, Shkenca, Historia dhe Anglishtja?
- Çfarë njohuri dhe aftësi pritet që të përveçtojnë nxënësi?
- Si u përgjigjen këto njohuri dhe aftësi standardeve shtetërore dhe kombëtare?

- Si mund të mësojnë prindërit mbi standardet shtetërore dhe kombëtare?
- Sa janë të informuar nxënësit mbi këto standarde?

2. Progresi:

- Si po ecën fëmija im në klasë?
- A i kthen detyrat e shtëpisë në kohë?
- A është arritja e fëmijës sipas nivelit të klasës që ai/ajo është?
- Si është arritja e tij krahasuar me të tjerët në klasë?
- Cilat janë pikat më të forta të tij/saj?
- Si mund të përmirësohet?

3. Detyrat dhe Vlerësimet:

- Çfarë projekte dhe detyra do t'i kërkohej nxënësit të plotësojë?
- A mund të shikojë disa nga detyrat e plotësuara?
- Si janë vlerësuar detyrat?
- Si është përcaktuar nota përfundimtare?

4. Mësimi në shtëpi:

- Çfarë mund të bëni në shtëpi për të ndihmuar dhe plotësuar atë që bëhet çdo ditë në shkollë?
- Si mund ta dini se çfarë detyrash caktohen çdo ditë?
- Çfarë burime të tjera mund të keni në përdorim (si libra, websaite, klube jashtëshkollre)?
- Ndani çdo strategji që ju jeni duke përdorur ose mendoni të përdorni në shtëpi për të mbështetur suksesin në mësime të fëmijës tuaj.

5. Mendimet tuaj mbi fëmijën tuaj:

- Sigurohuni që të ndani me mësuesin mendimet dhe ndjenjat tuaja mbi fëmijën tuaj.
- Flisni me mësuesin rreth gjërave që fëmija juaj di të bëjë më mirë.
- Shpjegoni se ku ai apo ajo ka më shumë nevojë për ndihmë.

6. Përshtatja e metodave të ndryshme të të mësuarit:

- Çfarë ndodh nëse fëmija nuk i kap mësimet shpejt dhe mbetet mbrapa ose i kap shumë shpejt ato dhe s'ka interes e mërzhitet? Çfarë mund të bëjë mësuesi për të mbështetur fëmijën tuaj kur ai ose ajo ka nevojë?
- Çfarë mbështetje suplementare ka shkolla apo komuniteti për nxënësit që kanë rezultate nën nivelin e duhur ose ata që janë më të përparuar?
- A ka programe që ndihmojnë me detyrat e shtëpisë, tutorim apo të tjera për nxënësit që kanë nevojë për ndihmë suplementare?